

**VENDIM**  
**Nr. 493, datë 19.6.2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1039, DATË 14.10.2009, NR.120, DATË 17.2.2011 DHE NR.435, DATË 24.4.2013, PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE MBI SIPËRFAQET TAKUESE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15/1 e 32, pika 1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimet e mëposhtme të Këshillit të Ministrave, për shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, bëhen këto ndryshime:

a) Lista e bashkëpronarëve bashkëlidhur vendimit nr.1039, datë 14.10.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet për 1 (një) pasuri në Drejtorinë e ALUIZNI-t, Tirana 1, sipas lidhjes “A”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Lista e bashkëpronarëve bashkëlidhur vendimit nr.120, datë 17.2.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet për 1 (një) pasuri në Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat, sipas lidhjes “B”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Lista e bashkëpronarëve bashkëlidhur vendimit nr.435, datë 24.4.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet për 7 (shtatë) pasuri në Drejtorinë e ALUIZNI-t Krujë, sipas lidhjes “C”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**